



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

Tiranë më 23.07.2014
Dokument parlamentar

R A P O R T

“Për Dekretin e Presidentit të Republikës, nr. 8633, datë 18.07.2014 “Për kthimin përrishqyrtim të ligjit nr. 64/2014 “Për pushtetet dhe Autoritetet e Drejimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në cilësinë e komisionit përgjegjës, në mbledhjen e datës 23 korrik 2014, mori në shqyrtim dekretin e Presidentit të Republikës nr. 8633, datë 18.07.2014 “Për kthimin përrishqyrtim të ligjit nr. 64/2014 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Për zhvillimin e procedurës së shqyrtimit të dekretit, komisioni ftoi përfaqësues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Presidenti i Republikës, bazuar në nenin 85, pika 1 dhe 93 të Kushtetutës, ka vendosur kthimin e ligjit nr. 64/2014 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejimit e të Komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, për këto arsy:

Arsyet e kthimit të ligjit nr. 64/2014, janë:

- Ky ligj, sjell ndryshime të cilat kanë pasoja kritike në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit si dhe në balancën e ndarjes së pushteteve midis Kuvendit, Presidentit, Kryeministrit dhe autoriteteve të tjera të përektuara në ligj.
- Ky ligj, ka minimizuar kompetencat e Presidentit të Republikës në një nga detyrat kryesore që i njeh Kushtetuta, kjo për arsy se: kalimi i kompetencës përmiratimin e strukturës organizative dhe planin e përhapjes dhe vendosjes të FA nga Presidenti te Kryeministri, për këto arsy parashikimet e nenit 12 pikat ‘d’ dhe ‘dh’ të ligjit nr. 64/2014 nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

- Kufizimi i kompetencave të Presidentit të Republikës lidhur me emërimet, lirimet e ushtarakëve me gradë madhore (gjeneralët) nuk është i justifikuar.
- Ky ligj ka krijuar vakum ligjor pasi, janë suprimuar disa kompetenca ligjore të Presidentit të Republikës si psh. për urdhërimin e fillimit të veprimeve luftarake, kur shkëlet integriteti i hapësirës tokësore, ajrore e detare të RSH, vendosja e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura në kushtet e masave të jashtëzakonshme.
- Ky ligj përvçe se kufizon ndjeshëm kompetencat e Presidentit si komandant i FA, nuk parashikon shprehimisht detyrimin e Kryeministrit dhe të Ministrtit të Mbrojtjes që të jenë përgjegjës para Kuvendit dhe Presidentit të Republikës për drejtimin dhe gjëndjen e FA në kohë paqeje.

➤ **Baza Ligjore**

A. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Neni 85

1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.
2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë, kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

B. Rregullorja e Kuvendit

Neni 86

Dekreti i Presidentit të Republikës për rishqyrtim ligji

1. Kur Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 85 të Kushtetutës, rikthen ligjin për rishqyrtim në Kuvend, Kryetari i Kuvendit e kalon menjëherë atë për shqyrtim në komisionin përgjegjës që e ka shqyrtuar fillimisht.
2. Komisioni përgjegjës e shqyrton dekretin vetëm për çështjet e paraqitura nga Presidenti i Republikës dhe brenda 8 javëve nga data e fillimit të shqyrtimi paraqet raportin e tij. Ky raport përmban mendimin e komisionit dhe, sipas rastit, edhe propozime për nene të veçanta të ligjit.

I. *Lidhur me arsyen e parë* se ky ligj, sjell ndryshime të cilat kanë pasoja kritike në ushtrimin e kompetencave kushtetuese të Presidentit si dhe në balancën e ndarjes së pushteteve midis Kuvendit, Presidentit, Kryeministrit dhe autoriteteve të tjera të përcaktuara në ligj.

Duke krahasuar ligjin nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Komandimit e të Drejimit Strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, ligji ende në fuqi, me ligjin nr. 64/2014, “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejimit e të Komandimit

të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë" të cilin Presidenti i Republikës e ka kthyer për rishqyrtim në Kuvend, në raport me kompetencat kushtetuese të autoriteteve kryesore drejtuese ndaj Forcave të Armatosura vërehet se, janë respektuar të gjitha kërkesat/dispozitat kushtetuese dhe Presidentit të Republikës *nuk i është cënuar asnjë kompetencë që të prishë balancën e ndarjes së pushteteve dhe të autoriteteve në raport me Forcat e Armatosura*, përkëto arsyen:

Presidenti i Republikës, Kushtetuta e Shqipërisë i njeh këto kompetenca në drejtim të Forcave të Armatosura:

- a) neni 92/d i Kushtetutës, "jep gradat mië të larta ushtarake sipas ligjit"
- b) neni 168 pika 2 e Kushtetutës, "Presidenti i Republikës është Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura"
- c) neni 169 i Kushtetutës, shprehet qartë se "*Presidenti i Republikës, në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrat dhe ministrit të Mbrojtjes.* 2. Presidenti i Republikës, në kohë lufte, emëron dhe shkarkon Komandantin e Forcave të Armatosura me propozim të Kryeministrat. 3. Me propozim të Kryeministrat, emëron dhe shkarkon Shefin e Shtabit të Përgjithshëm, si dhe me propozim të ministrit të Mbrojtjes, emëron dhe shkarkon komendantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore. 4. **Kompetencat e Presidentit** të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe ato të Komandantit të Forcave të Armatosura dhe varësia e tyre nga organet kushtetuese, caktohen me ligj.

Në respektim të plotë të kërkesave kushtetuese të sipërpërmendura, ligji nr. 64/2014, "Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejtimit dhe të Komandimit të Forcave të Armatosura të RSH", në Kreun II, "Hierarkia e Autoriteteve dhe Pushtetëve të Drejtimit e të Komandimit në Forcat e Armatosura", Neni 7 i ligjit përcakton mjaft qartë se në hierarkinë e autoriteteve të drejtimit e të komandimit, Presidenti i Republikës parashikohet dhe i njihet e drejta kushtetuese si autoritet drejtues dhe komandant i Forcave të Armatosura në respektim të nenit 168 pika 2 të Kushtetutës, ku përcaktohet si "*Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura*". Dispozit e cila nuk ka asnjë ndryshim krahasuar me nenin 3 të ligjit aktual në fuqi.

neni 9 i ligjit, siguron edhe njëherë detyrimin kushtetues se Presidenti i Republikës, në cilësinë e Komandantit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, ushtron pushtetin e dhënë nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi dhe se në kohë paqeje, ushtron drejtimin e Forcave të Armatosura nëpërmjet Kryeministrat dhe ministrit të Mbrojtjes, ndërsa në kohë lufte i drejton FA nëpërmjet Komandantit të FA. Përcaktim i cili siguron dhe garanton kompetencat shprehimisht të njohura në Kushtetutën e RSH dhe në ligjin nr. 64/2014, të cilat nuk mund të prishin balancën kushtetuese ndërmjet pushtetëve dhe autoritetëve të komandimit dhe të drejtimit në raport me Forcat e Armatosura përsa kohë nuk kanë kaluar apo cënuar asnjë kompetencë duke respektuar kornizat kushtetuese të njohura gjithsecilit pushtet në raport me FA.

II. Lidhur me arsyen e dytë se ky ligj, ka minimizuar kompetencat e Presidentit të Republikës në një nga detyrat kryesore që i njeh Kushtetuta, kjo për arsyen e: kalimi i kompetencës për miratimin e strukturës organizative dhe planin e përhapjes dhe vendosjes të FA nga Presidenti te Kryeministri, për këto arsyen parashikimet e nenit 12 pikat ‘d’ dhe ‘dh’ të ligjit nr. 64/2014 nuk janë në përputhje me Kushtetutën.

Arsyetimi se pikat “d” dhe “dh” të nenit 12, “...miratimi i strukturës së FA dhe planit të përhapjes...” nuk janë në përputhje me Kushtetutën pasi nga kompetencë e Presidentit i kanë kaluar Kryeministrin”...

Presidenti në arsyetimin e tij nuk ka shprehur asnjë dispozitë konkrete kushtetuese e cila është shkelur nga pikat ‘d’ dhe ‘dh’ të nenit 12 të ligjit, kjo për arsyen e thjeshtë se ska asnjë dispozitë kushtetuese e cila të shkelet apo të gjejë kundërshti me nenin 12 të ligjit. Lidhur me pretendimin se duke hequr këto dy kompetencia Presidentit të Republikës i hiqet dhe minimizohet drejtimi i Forcave të Armatosura, sqarojmë se drejtimi i FA është një koncept shumë më i gjërë se miratimi strukturës dhe planit të përhapjes së FA. Këto kompetencia janë kompetencia të cilat për shkak të natyrës së tyre kanë karakter të pastër ekzekutiv dhe nuk mund të pretendohet kurrsesi se janë në shkelje të Kushtetutës, pasi dhe vetë neni 169 i Kushtetutës (menaxhimi dhe drejtimi i FA në kohë paqeje nga Kryeministri dhe Ministri) për vetë natyrën e këtyre kompetencave në zbatim të mirmenaxhimit dhe operacionalitetit të FA lejon që këto kompetencia ti përkasin Ministrit së Mbrojtjes dhe Kryeministrin.

III. Lidhur me arsyen e tretë se kufizimi i kompetencave të Presidentit të Republikës mbi lirimet e ushtarakeve me grada madhore (gjeneralët) nuk është i justifikuar,

Nuk është dhënë asnjë argument se pse këto ndryshime nuk janë të justifikuara. Këto ndryshim balancojnë shpërndarjen e pushteteve mes ekzekutivit dhe Presidentit si dhe i rit fleksibilitetin në menaxhimin e karrierës së ushtarakeve me grada madhore. Kompetencat e pastra kushtetuese të Presidentit të Republikës në lidhje me menaxhimin e karrierës së një pjese të ushtarakeve me grada madhore nuk janë prekur, pasi *pika 3 e nenit 9 të ligjit* përbush dhe siguron kompetencën e tij kushtetuese të nenit 92 pika ‘ç’ dhe ‘d’, ku Presidenti si Komandant i Përgjithshëm i FA, *“jep gradat madhore, me propozim të ministrit të Mbrojtjes”*, “emëron, gradon, liron nga detyra dhe nxjerr në rezervë ose lirim me propozim të Kryeministrit, Shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA”, *“emëron dhe liron nga detyra, me propozim të ministrit të Mbrojtjes, komandantët e forcave tokësore, detare dhe ajrore. (neni 169 pika 3 e Kushtetutës)*

IV. Lidhur me arsyen e katërt se ky ligj ka krijuar vakum ligjor pasi, janë suprimuar disa kompetencia ligjore të Presidentit të Republikës si psh. për urdhërin e fillimit të veprimeve luftarake, kur shkelet integriteti i hapësirës tokësore, ajrore e detare të RSH, vendosja e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura në kushtet e masave të jashtëzakonshme.

Këto pretendime nuk qëndrojnë pasi, neni 9 shkronjat “d” shpreh qartë këto kompetencia si: “urdhëron vendosjen e shkallëve të ndryshme të gatishmërisë luftarake të Forcave të Armatosura, në kushtet e masave të jashtëzakonshme;

dh) vendos për mobilizimin dhe për provat e gatishmërisë së njësive ushtarake rezervë; e) miraton regjimin, rregullat e gatishmërisë luftarake dhe ngritjen në kushtrim të Forcave të Armatosura;


- **Në lidhje me kushtet e masave të jashtëzakonshme**, Kushtetuta për vetë rëndësinë që kanë masat në gjëndje të jashtëzakonshme nuk është kënaqur vetëm me nivelin e parashikimeve ligjore të kompetencave dhe detyrimeve të autoriteteve përkatëse kushtetuese në raport edhe me angazhimin e FA në këto kushte, por parashikohet dhe rregullohet në nivel kushtetues në Pjesën e 16 (gjashtëmbëdhjetë), nenet 170, 171, 172 dhe 173 të Kushtetutës ku shprehen mjaft qartë të drejtat dhe detyrimet e gjithsecilit pushtet, përfshirë kompetencat e Presidentit të Republikës, Kuvendit të Shqiprësis dhe Këshillit të Ministrave. Gjithashtu roli i FA në kushtet e masave të jashtëzakonshme (luftë, gjendje e jashtëzakonshme, fatkeqësi natyrore) si dhe detyrat e përgjegjësive e pushteteve dhe autoriteteve të drejtim-komandimit të FA gjatë kësaj kohe janë trajtuar në mënyrë të detajuar në përputhje me dispozitat kushtetuese të sipërpermendura edhe në Kreun III nenet 20 deri në 23 të ligjit nr. 64/2014.

Përsa i përket arsyetimit të fundit se në ligj nuk është parashikuar shprehimisht detyrimi i Kryeministrit dhe Ministrit të Mbrojtjes për të qenë përgjegjës para Kuvendit dhe Presidentit të Republikës për drejtimin dhe gjendjen e FA në kohë paqeje, theksojmë se raportet e ekzekutivit me institucionin e Presidentit dhe me legjislativin janë raporte kushtetuese të cilat gjejnë rregullim mjaftë të qartë në aktin themeltar të shtetit, Kushtetutën e Shqipërisë.

Përfundim: Përsa u parashtrua më sipër, Dekreti i Presidentit nuk është bindës dhe nuk përmban asnjë arsy ligjore dhe kushtetuese për të rishqyrtuar ligjin nr. 64/2014, “Për Pushtetet dhe Autoritetet e Drejimit e Komandimit të Forcave të Armatosura të RSH” pasi nuk janë cënuar asnjë dispozitë apo kompetencë kushtetuese të Presidentit të Republikës në parashikimet e ligjit nr. 64/2014.

Për këto arsy, bazuar në ninen 85 pika 2 e Kushtetutës, komisioni për sigurinë kombëtare me shumicën e anëtarëve të tij votoi kundër dekretit të Presidentit të Republikës.

Relator



Kryetar

Spartak BRAHO